



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura e V-të  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 21/15  
Prishtinë, më 3.6.2015, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjoni, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Bali Muharremaj, dhe Enver Hoti.  
Shqipe Pantina nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Munguan: Jelena Bontić, Ilir Deda dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Behxheti – Kryetar i Bordit të RTK-së, Mentor Shala – Menaxher Ekzekutiv i RTK-së, Adelina Vala – Menaxhere e Financave të RTK-së, Musa Shabani – Kryesues i Bordit të KPMM-së, Ramiz Krasniqi – Antar i Bordit të KPMM-së, Haradin Gërvalla – Kryesues i Departamentit të Financave të KPMM-së, Festim Kutullovci - Anëtar i Bordit të KPMM-së, Kemajl Zeqiri – Anëtar i Bordit të KPMM-së, Azem Rexhaj – Anëtar i Bordit të KPMM-së, Medin Bojaxhiu – Drejtor në KPMM, Emrush Haxhiu – Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Istret Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa në Kuvendin e Kosovës

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami nga GIZ, Mejreme Tahirukaj Bardhyl Bekteshi, Arsim Halili, Fadil Hoxha dhe Edona Musa nga RTK, Liridonë Xhemajli nga RTV21, Sarada Rama nga Koha Ditore, Floriana Shala nga OSBE, Mehdi Mulaj nga BIRTH, Kaltrina Ahmenti nga GLPS, Shefki Kastrati nga NDI, Visar Rushiti nga GAP.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, ma datë 13.5.2015, 20.5.2015 dhe 27.5.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Radiotelezionit të Kosovës për vitin 2014;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2015;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2016/01;**

- 6. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014;**
- 7. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** – konstatoi se rendi i ditës miratohet me ndryshimin e pikave dhe si pikë e katërt të do të jetë: Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014. Ndërkaq pika katërt dhe e pestë, kalojnë si pika e pestë dhe e gjashtë.

### **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, ma datë 13.5.2015, 20.5.2015 dhe 27.5.2015**

**Kryetari** – konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Radiotelezionit të Kosovës për vitin 2014**

**Kryetari** – RTK-ja ka pas një buxhet rreth 8,848,000€, kurse me rishikim të buxhetit, RTK-së i janë ndarë edhe 500.000€ dhe gjithsej nga buxheti i Kosovës janë ndarë 9,348,000€. RTK-ja ka mbuluar një pjesë të shpenzimeve prej 20% nga të hyrat e veta. Gjithsej buxheti i RTK-së për vitin 2014 është 11,248,000€, ndërsa shpenzimet janë në shumë prej 12,110,363€ apo 108%. Pra ka një tejkallim ndaj mjeteve të planifikuara për 862,363€ apo 8%. Komisionin për Buxhet dhe Financa, në të kaluarën si komision funksional, vazhdimish ka trajtuar raportet e RTK-së dhe ka dhënë disa rekomandime, për qka RTK nuk iu përgjigjur rekomandimeve për dërgimin e një raporti të detalizuar për borxhin e akumuluar dhe mënyrën dhe afatet kohore për shlyrjen e borxhit. Nga raporti shohim se ka tejkallime në kategoritë për paga dhe mëditje, mallra dhe shpenzime, dhe shpenzimet komunale. Ndërsa, nuk ka tejkallim tek investimet kapitale dhe si rezultat kemi një përqindje shumë të vogël të realizuar. Duhet të sqarohet tejkallimi për paga dhe mëditje për 14.5%? Me ligj të buxhetit RTK-së i janë ndarë 6,000,000 € për 708 të punësuar, ndërsa janë shpenzuar 6,869,864€ edhe pse disa punëtor kanë qenë në pushim të lehonisë dhe 9 punëtor kanë dalë në pension. Po ashtu duhet të sqarohen mëditjet e bordit në shumë prej 153,000€. Qfarç nënkuptohet me shpenzimet tjera të mallrat dhe shërbimet që janë në shumë prej 254.000€? Po ashtu kërkohet një informim për situatën lidhur me borxhet dhe me kredin që është marrë nga Pro Credit Bank?

**Ismet Bexheti** – raporti është dorëzuar ashtu si e kërkon ligji dhe pasqyrat financiare të RTK-së janë në përputhje me standartet ndërkombëtare. Të hyrat e RTK-së nga buxheti i Kosovës janë 80%, ndërsa nga marketingu janë 18%, dhe të hyrat tjera janë 2%. Në rishikimin buxhetor është miratuar një kërkesë për 500.000€. Të hyrat e realizuara për vitin 2014 janë në shumë prej 11,676,085€. Në periudhën raportuese shpenzimet janë më të mëdha se të hyrat. Ka tejkallime për paga dhe mëditje prej 14.5%, për mallra dhe shërbime 9%, dhe për shpenzimet komunale 8%. Për investime kapitale janë shpenzuar vetëm 62% e planifikimit.

**Kryetari** – a janë bartur mjetet e pasqyruara nga investimet kapitale për këto tejkallime në kategoritë për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime? Përndryshe nga ka ardhur financimi për tejkallimet?

**Adelina Vala** – në pyetjen e kryetarit, sqaroi se një pjesë e mjeteve janë bartur nga investimet kapitale në kategoritë tjera.

**Ismet Bexheti** – në vitin 2014 RTK-ja është ballafaquar me shumë sfida dhe si rezultat ka ndikuar në implikime financiare. RTK-2 ka obliguar që të rekrutohen punëtor nga mesi dhe fundi i vitit 2013

prandaj ka rritje në aspektin financiar. Po ashtu ndryshime ka pas edhe me RTK 3 dhe 4 në mënyrë që të forcohet besueshmëria dhe shikueshmëria. Ndërsa për mallra dhe shërbime RTK ka qenë e detyruar të përmbush një aspekt ligjor i cili ka kushtuar mbi 1 milion euro për transmetimin e kampionateve ndërkombëtare.

**Bali Muharremaj** – në bazë të cilit ligj keni arritur të keni tejkalime tek pagat dhe mëditjet për 14%? Ka tejkalim të numrit të punëtorëve mbi 230 që janë me kontratë mbi vepër. Sa është borxhi i RTK-së dhe kujt i përket dhe në bazë të cilit ligj?

**Besa Gaxherri** - të hyrat në shumë prej 8,848,000 € janë nga buxheti i Kosovës, ndërsa të hyrat nga marketingu janë 1,700,000€ dhe të hyrat tjera që duhet sqaruar janë 200,000€. Raporti financiar është dashtë të jetë më konkret sa i përket të hyrave tjera. Një menaxher i mirë insiston dhe ka për obligim të orientoj buxhet për investime kapitale. Në çdo rregull financiar pagat dhe meditet nuk mund të shkoj mbi 30%. Jemi në dijeni me rrethanat, mirëpo kjo shuma për paga dhe meditje prej 6,869,000 € dhe shuma për investime kapitale prej 623,000€ është e papranueshme. Nuk keni qenë të rregullt edhe në raportime dhe ligji nuk lejon që të shpenzohet paraja nëse nuk ka mjete. Shuma prej 212,906€ për shpenzime jasht vendit, po ashtu i keni edhe 74,000€ shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit që është dashtë të sqarohen se qka janë këto shpezime tjera. Në vitin 2013 shpenzimet e telefonisë mobile janë 121,000€, ndërsa për vitin 2014 janë 140,000€ edhe pse ka pasur ujle të çmimeve të telefonisë. Shërbimet kontraktuese tjera janë në shumë prej 3,458,467€ dhe nuk ka sqarime. Çka janë këto paisje tjera në shumë prej 307,874 €? Çka është kapital tjetër në shumë prej 315,000 €? Te pagat dhe meditet janë 708 puntorë dhe paga mesatare del rreth 900€.

**Labinotë Demi-Murtezi** – a keni shfrytëzuar ndojnë parametër matës mbi bazën e shikueshmërisë të deritanishëm të televizionit tuaj apo në krahasim me televizionet tjera? Janë shqetësuese kontratat mbi vepër. A ka RTK-ja rregullore të punës për cilësi? Shohim ad hoc emisione të reja nga të cilat nuk po marrim atë çka dëshirojmë.

**Enver Hoti** – pyeti për sa kohë qëndrojnë kontratat mbi vepër? A po vazhdojnë ende punësimet e tilla edhe në këtë kohë kur keni deklaruar borxh dhe qëndroni në një gjendje të vështirë financiare? Raporti i auditimit të pavarur a është bërë nga e njëjta kompani? Nuk është përcjell në raport asnjë rekomandim i auditimit.

**Shqipe Pantina** – kur është shqyrtuar raport i punës në komisionin funksional ka pasur shumë vërejtje për mënyrën e menaxhimit në tërësi të RTK-së dhe kemi gjetur përgjigje për mënyrën se si ato programe janë mbuluar në anën financiare. Në raport, te pjesa narrative është një listë e trajnimeve që thuhet se janë ndjek, por nuk ka sqarim për shumën e shpenzuara në ato trajnime dhe mungojnë specifikat se si kanë ndikuar këto trajnime në ngritjen e performancës ose punës së RTK-së. Përveç numrit të punëtorëve që është shtuar, janë tejkaluar të gjitha planifikimet. Tejkalimi i pagave dhe meditjeve është 14%, dhe mungon sqarimi se kush ka marr vendim për të financuar pagat dhe meditet prej kategorisë investime kapitale? A ka një vendim nga Kuvendi, sepse Kuvendi si themelues i RTK-së duhet të vendos për ndryshime të tilla? Po ashtu shqetësimet e ngritur në mënyrën e menaxhimit të paisjeve të RTK-së për të cilat thuhet që më shumë merren me qira se sa shfrytëzohen ato paisje të cilat i posedon RTK-ja. Përse regjistrimet e makinave nuk janë regjistruar tash e sa muaj?

**Mentor Shala** – në vitin 2013 RTK ka pas një program televiziv për 24 orë. Në gjysmën e dytë të vitit 2013 është hapur kanali i dytë në gjuhën serbe që ka qenë obligim ligjor. Me hapjen e kanalit të ri janë nevojitur punësime shtesë. Si rezultat gjatë vitit 2014 është rritur numri i të punësuarve rreth 100, disa nga këta janë në detyra specifike me kontrata mbi vepër, që e ka ngritur edhe nivelin e pagave. Buxheti

ka qenë i njejtë si në vitin 2012, 2011 dhe 2013, dhe ne kemi qenë të obliguar me hap RTK-2, dhe sipas Ligjit të RTK-së 10% e buxhetit të RTK-së, i dedikohet këtij kanali.

**Besa Gaxherri** - ju si menaxher, a keni hartuar projektin dhe a keni bërë parallogaritë dhe koston sa kushton RTK-2? A mund të na njoftoni konkretisht sa është paraparë numri i puntorëve dhe kërkesat e ndryshme buxhetore që janë paraparë?

**Mentor Shala** – nuk ka qenë projekt i RTK-së, por ka qenë obligim ligjor themelimi i RTK-2. Projekti për RTK-2 është bërë nga një grup punues i themeluar nga bashkësia ndërkombëtare dhe vendore. Grupi punues ka filluar të punojë në vitin 2009 dhe pjesmarësit kanë qenë përfaqësuesit e ambasadave dhe të Kuvendit të cilit e kanë hartuar projektin. Hapja e RTK-3 dhe RTK-4 ka ndikuar tek pagat dhe medijtë të vitit 2014. Mund të shtrohet pyetja se përse janë hapur këto programe me qenë sa nuk ka pasur mjete. Mirëpo ne jemi transmetues publik dhe medium dhe tregu medial vazhdimisht zhvillohet. Është përcjell borxhi i së kaluarës tek pagat dhe medijtë po ashtu edhe hapja e Kanalit 2 ka rënduar këtë kategori për paga dhe medijtë. RTK është detyruar të veprojë me buxhetin e njëjtë, pavarshisht se në të kaluarën kanë qenë 24 orë program, ndërsa tani janë 96 orë program.

**Kryetari** – në bazë të buxhetit, paga mesatare e nivelit menaxhues del të jetë është 1,856 €, ndërsa niveli profesional dhe niveli mbështetës kanë pagën mesatare 792 €, që është një diferencë e madhe mbi mesataren e shërbyesve civil në Kosovë. Si e konsideroni ju veten si medium publik të barabartë me mediumet tjera kur ju i keni 10 milion euro pare të gatshme nga buxheti i Kosovës?

**Mentor Shala** – televizionet zhvillohen vazhdimisht dhe për këtë jemi në dijeni krijohen platforma të reja dhe të gjitha këto kanë kosto. Digjitalizimi është e nevojshme të fillojë si proces, për të cilin RTK nuk ka mjete financiare sepse ka kostë të lartë dhe me këtë buxhet është e pamundur me fillue një procesi të tillë. Janë shumë elemente për të cilat RTK është detyruar të plotësojë për shkak të obligimeve ligjore. Siç është rasti të mallrat dhe shërbimet, ku në bazë të Ligjit të RTK-së, duhet të japim rëndësi edhe sportit sidomos kampionatit ndërkombëtar dhe vendor. Në këtë drejtim, në vitin e kaluar RTK, nga mallra dhe shërbimet, ka paguar vetëm për drejtat sportive rreth 1 milion euro. RTK ka ndërtuar studio me shpenzime minimale në garazhda dhe me gjendje shumë të keqe.

**Mentor Shala** –shpenzimet për renovimet e studios, janë një pjesë e shpenzimeve nga kategoria për mallra dhe shërbime. Në vitin 2014, të shërbimet publike është rritur tatimi në pronë për 300% më shumë. RTK-2 ka ndikuar në rritjen e shpenzimit të telefonisë sepse për 100 punëtor janë shtuar 100 numra dhe e njëjta vlenë edhe për udhëtimet zyrtare. Mosregjistrimi i veturave ka të bëjë me çështjen e pagesës së tatimit në pronë. RTK është në një proces gjyqësor me komunën pikërisht për arsyen e rritjes 300% të tatimit në pronë.

**Enver Hoti** – nuk u dhanë parametra se cilat janë krahasuesit matës që janë bërë, por vetëm informata ose parametra anketimi të brendshëm e jo të pavarur. Në bazë të informatës që u dha për rritjen e programit në 96 orë sa përqind e këtyre janë ritransmetime ose përsëritje e transmetimeve dhe sa ju keni të hyra nga zgjatja e programit?

**Mentor Shala** – RTK-ja rreth 15 orë prodhon programin të vet. Te RTK-1 janë edicionet e lajmeve, programet argëtuese dhe programet debatuese. RTK-3 prodhon lajme nga ora 7:00 të mëngjesit deri ora 12:00 të mërkurës. Mirëpo gjatë natës ka ripërsëritje të lajmeve për arsye se nuk ka aq zhvillimeve në Kosovë dhe RTK nuk ka servisë ndërkombëtar që të ketë vazhdimësi gjatë natës programi. RTK-2 prodhon program të vet rreth 10 orë, ndërsa RTK-4 është ende në fazë eksperimentale që merret me arkiva dhe programe tjera përveq edicioneve të lajmeve që do të thotë se nuk ka repriza dhe nuk ka ritransmetime të programeve.

**Enver Hoti** – RTK mund të ketë shikueshmëri shumë në nivel për sportet. Ndërsa sa i përket programeve tjerave shikueshmëria e RTK-së është në nivel të dobët sepse nuk ofron programe familiare.

**Kryetari** – njoftoj se me nenin 21.4 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, është përcaktuar shuma dhe koha e financimit të RTK-së nga buxheti i Kosovës dhe hapat që duhet të ndërmerren nga aktorët përgjegjës për gjetjen e mënyrës afatgjate të financimit të këtij mediumi publik. Sipas Ligjit të RTK-së, financimi nga buxheti i Kosovës ka përfunduar në muajin maj të këtij viti dhe kjo krijon telashe për sigurimin e mjeteve. Nëse RTK nuk dërgon një propozim deri në tetor, RTK do të mbet pa financim. Raportet nga RTK duhet të jenë më të detalizuara dhe të specifikuara për të hyrat dhe shpenzimet. Po ashtu RTK duhet jep një përgjigje lidhur me borxhin. Sa janë borxhet dhe si do të mbulohen këto mjete? Dëshirojm që të kemi më shumë emisione edukative, shoqërore, dhe ambientaliste. Raporti që do ti prezantohet Kuvendit do të jetë i bashkangjitur me Raportin e performancës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë:

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit, të shqyrtojë Raportin financiar vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2014.

#### **4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014**

**Kryetari** – theksoi se buxheti fillestar i KPMM-së i ndarë nga Qeveria është 1,835,064 €, por me vendim të Qeverisë për shkurtime buxheti përfundimtar ka qenë në shumë prej 1,758,600 €. Po ashtu Vendimi i Qeverisë për rritjen e pagës ka ndikuar në pozicionin e kategoris për paga dhe meditje. Të hyrat janë të prezantuara në shumë prej 26,966,931.02 €.

**Musa Shabani** - buxheti në fillim të vitit ka qenë i aprovuar 1,835,064 euro, pas rishikimit për ndaljen e mjeteve buxheti ka mbetur 1,758,600 euro për vitin 2014, kurse i shpenzuar ka qenë 1,552,996.13 euro. Projektet kapitale të cilat janë realizuar gjatë vitit 2014 janë ndërtimi i një plancente të vogël gjeologjike, menagjimi i minierave e minerale, blerja e veturave, hardueri dhe softuerit. Projektli i plancentes është i vetmi projekt i cili është në vazhdimësi për vitin 2015, deri sa shërbimi i gjeologjisë së Kosovës të jetë i gatshëm për marrjen e kompetencave.

**Kryetari** – ju lutem të na zbërtheni të hyrat prej 26 milion euro?

**Ramiz Krasniqi** – të hyrat gjatë vitit 2014 janë realizuar nga taksat administrative që janë 180,075, nga gjobat administrative 147,246 euro dhe rentat minerare 26,538,79 euro.

**Kryetari** – pyeti qka është renta minerare?

**Ramiz Krasniqi** – renta minerare është taksa që e paguajn kompanitë që kanë licenca të lëshuara nga KPMM, për hulumtim apo shfrytëzim të mineraleve në republikën e Kosovës.

**Kryetari** - sa është numri i gurthyesve dhe nga cilat kompani i keni të hyrat më të mëdha?

**Ramiz Krasniqi** – renta që është paguar ka qenë 25 milion euro. Feronikeli ka paguar 2,28,672,39 euro, Trepça ka paguar 66,619 euro. Minerale energjetike ky hyn qymyri KEK-u ka paguar 21,952,23 euro, Ksella e cila e përdorë rëren për prodhimin e bllokave e materile ndërtimore 13,368 euro.

**Kryetari** - sa janë gurthyes të licencuar?

**Ramiz Krasniqi** – janë të licencuar 190 gjatë vitit 2014.

**Kryetari** – në bazë të qfarë kriteresh paguhet renta minerare. Si bëhet kontrollini për shfrytëzimin e sasisë së rentës?

**Ramiz Krasniqi** – kompanitë raportojnë çdo tre mujor, nëse inspektorët tanë gjejnë mosërpëthje të rezervave të shfrytëzuara atëherë formohet komisioni dhe verifikohet përmes departementit të gjeodezisë se a janë të sakta resurset që janë këtu.

**Latif Gashi** – më intereson për kompanitë hulumtuese që janë 112, a i keni nën mbikqyrje këto kompani se qka hulumtojnë, të cilat kanë mundësi për keqpërdorimit të pasurisë që ka Kosova. A janë kompani vendore apo ndërkombetare, cili është raporti juaj me këto kompani, qfarë takse paguajnë?

**Safete Hadergjonaj** - a ka ndonjë kompani që nuk e ka paguar renten dhe nëse po qka keni ndërmarrë ndaj tyre. Po e shoh këtu listën e aktvendimeve ndaj kompanive ilegale janë 85 kompani ilegale që i keni shqiptuar gjrobat. Nëse i shohim të hyrat nga gjrobat administrative janë planifikuar 1,200,000 dhe janë inkasuar 147, 247, qfarë keni ndërmarrë ndaj kompanive që nuk i paguajnë gjrobat?

**Bardhyl Meta** – nga raporti shofim se Trepça ka paguar 66,000 euro. A ka qenë gjithmonë kjo shumë se për mua është një shumë e vogël me krahasuar me të tjerat. Ka përfolje se materiali prej aty është shitur në menyrë ilegale, nëse është kështu a keni të dhanuna dhe qka është ndërmarrë në ato raste? Sa është pjesëmarrja e pjesës veriore në raport me pjesën tjetër.

**Besa Gaxherri** - jam dakort me gjithë kolegët për shqetësimet e ngritura dhe mendoj se nuk duhet aprovuar raportin deri se ti sjellin informata shtesë për gjithë pyetjet që u ngriten. Sa i përket shpenzimeve, shifet se në kategoritë kryesore nuk keni tejkalime, por tek shpenzimet e udhëtimit prej 77,000 janë shumë. Trajnimet janë 10,000, keni blerë mjaftë kompjutere, por edhe keni mirëmbajtur kompjuter, dhe këto dyja nuk shkojnë bashkë. Sa i përket gurthyesve keni shumë për të bërë dhe duhet me e krye punën siç e përcakton ligji.

**Safete Hadergjonaj** – në raport i kemi të prezantuar detyrimet e kompanive ndaj KPMM-së dhe nga kjo listë gjithsejt janë 15,320,000 euro borxhe. Kjo listë krahasuar me vite tjera qenka bërë e madhe, sepse atëherë e kemi pasur një faqe e gjysmë, e tash i kemi 10 faqe. Pse është rritur kjo listë, pse janë të gjitha këto borxhe?

**Enver Hoti** - në faqe 81 të raportit keni konstatuar se Trepça nuk e ka kryer obligimin financiar. Po ashtu siç e përmendet detyrimet e kompanive ndaj KPMM arrijnë shifren mbi 15 milion euro, që është shqetësuese dhe jep një pasqyrë përtej kësaj. Unë mendoj se këtu keni pengesa ndërinstitucionale dhe ju si KPMM duhet me iu adresu e me kerkue mbështetje të Kuvendit, dhe duheni me dhënë saktë treguesit dhe kush janë ata që i bëjnë këto pengesa. Po ashtu edhe 77 kallëzime penal që i keni ngritur cila është mbështetja juaj në këto. Unë mendoj se përtej atyre listave ka implikime të zyrtareve të lartë.

**Ramiz Krasniqi** - i kemi 112 kompani që merren me hulumtime, e këtu perfshihen kompani që merren me resurse metalore. Janë disa kompani që janë të huaja dhe janë të interesuara me hulumtue

metalet në Kosovë. I kemi nën mbikëqyrje, licenca e hulumtimit për metalet jepet për tri vite sipas ligjit të minierave, e vazhdimi i këtyre është dy herë nga dy vite. Kompanitë që kanë licenca, për metale paguajnë taksë 1000 euro, ndërsa 1400 euro kur e terheq licencën. Për mbajtjen e licences, vjetore kompanitë paguajnë 1400 euro që është për metale, kurse për jometale 500 euro. Sa i përket operuesve ilegal 85 janë vetëm për vitin 2014. KPMM ka problem seriozë me operuesit ilegal, ku pas bërjes së raportit lënda dorëzohet në gjykatë që nuk janë shqyrtuar. Për me i ndaluar operuesit ilegale, një mbështetje e madhe, kërkohet jo vetëm nga Kuvendi por edhe prej institucioneve tjera. Në vitin 2014 nuk kemi mundur me e konfiskuar asnjë makinë, por në vitin 2013 janë 20 të konfiskuar nga inspektorati i minierave dhe mineraleve në bashkëpunim me policinë, sepse ka kërcënime nga operatorët.

**Kryetari** - në bazë të qkafit i keni vendosur gjambat administrative ndaj operatorëve ilegal?

**Ramiz Krasniqi** - në bazë të ligjit të minierave dhe mineraleve, i dërgojmë lëndët në gjykatë.

**Kryetari** – përveç se që i paditni në gjykatë, është detyrë e juaj që këtyre operatorëve ilegal, në bashkëpunim me policinë, t'iu ndaloni punën, dhe ti konfiskoni mjetet. Është e papranueshme kjo qfarë po ndodhë në Kosovës.

**Safete Hadergjona** - a iu ka kthyer ndonjë përgjigje prej 85 lëndëve që i keni dërguar në gjykatë?

**Latif Gashi** – teknikisht raporti është mirë i përgatitur. Po është ajo që e ngriti kryetari që duhet përgjegjësi më e madhe, ngase jeni një autoritet që jepni licenca por edhe për ruajtjen e shfrytëzimit të resurseve që i ka Kosova. Kemi miniera dhe pasur nëntokësore që po bëhen hulumtime dhe kuptova se paguhet një shumë e vogël nga kompanitë prej 1000 apo 500 euro. Duke mbështetur shqetësimet të ngritura nga kolegët, në të ardhmen duke e aprovuar këtë raport kisha keërkuar nga ju edhe më shumë përkushtim.

**Bardhyl Meta** – pyeti a ka paguar Trepqa tantiem 3 apo 4 vite më herët, sa ka qenë faktura dhe a ka qenë gjithmonë në këtë masë?

**Ramiz Krasniqi** - Trepqa, Stantërgu dhe Artana nuk kanë paguar fare tantiemë vitin e kaluar. Qka janë paguar janë vetëm prej pjesës veriore. Për operimet ilegale në veri nuk kemi të dhëna.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë:

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit, të shqyrtojë Raportin financiar vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2014.

### **5. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2015**

**Bardhyl Meta** – njoftoi se ka pasur një takim me administratën e Kuvendit dhe ka kërkuar që ti detalizojnë kërkesat dhe të japin sqarime për secilën kërkesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve të ofruara nga administrata e Kuvendit, Komisioni unanimisht për Kryesinë e Kuvendit, nxori këtë

## **Rekomandim**

1. Të miratohen kërkesat Kuvendit të Kosovës për mjete shtesë në rishikim të buxhetit për vitin 2015, si në vijim:
  - a. Programi “Anëtarët e Kuvendit”, në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”, të shtohet shuma prej 50,000€.
  - b. Programi “Administrata e Kuvendit”, në kategorinë “Investime Kapitale”, të shtohet shuma prej 140,000€, për Projektin “Modernizimi dhe Paisja me Teknologji Digjitale për Sallën Plenare dhe sallat konferenciale”.
2. Të miratohen kërkesat e Kuvendit të Kosovës për transferet e brendshme buxhetore në rishikim të buxhetit për vitin 2015, si në vijim:
  - a. Programi “Anëtarët e Kuvendit”, shuma prej 40,000€, nga kategoria “Paga dhe Mëditje”, të transferohet në kategorinë “Subvencione dhe Transfere”.
  - b. Programi “Administrata e Kuvendit”, shuma prej 69,040€ nga kategoria “Mallra dhe Shërbime”, të transferohet në dy kategori tjera ekonomike:
    - Në kategorinë “Shpenzime komunale”, në shumë prej 20,000€, dhe
    - Në kategorinë “Investime Kapitale”, për Projektin “Rifreskimi dhe Pavarësimi i TIK-ut”, në shumë prej 49,040€.
  - c. Programi “Stafi Mbështetës Politik”: shuma prej 21,000€, nga kategoria “Paga dhe Mëditje”, të transferohet në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”.
3. Kryesia e Kuvendit, ti rekomandojë Ministrisë së Financave, që kërkesat e Kuvendit sipas pikës 1 dhe 2 të këtij rekomandimi, t’i përfshijë në Rishikimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

## **6. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2016/01**

Pas diskutimeve dhe sqarimeve të ofruara nga administrata e Kuvendit, Komisioni unanimisht për Kryesinë e Kuvendit, nxori këtë

## **Rekomandim**

- I. Të miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016-2018, sipas dokumentit të bashkangjitur këtij rekomandimi, dhe Kryesia t’i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, t’i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016-2018.



## **7. Të ndryshme**

Në bazë të propozimeve të kryetarit të komisioni, Komisioni njëzëri vendosi krijimin e dy grupeve punuese si në vijim:

I. U krijuar grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin mbi të ardhurat e korporatave dhe Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Bardhyl Meta dhe Bali Muharremaj.

II. U krijuar grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për tatimin mbi të ardhurat e personale, me këtë përbërje: Besa Gaaxherri (kryesuese), Labiontë Demi-Murtezi dhe Enver Hoti.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:45**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Naser Osmani**